



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 16.1.2025

Nr. 277 prot.,

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni se është përgatitur projektvendimi si vijon:


1. Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor", i ndryshuar".

Propozoj thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e këtij projektvendimi.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimit dhe relacionit shoqërues.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Tiranë më	16.1.2025
Nr.	277 prot.,

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN
PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 05, DATË 20.11.2020, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR”, I NDRYSHUAR

1. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Referuar nenit 20 pika 1, shkronja “a”, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projekt akte me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

Komisioni Rregullator ka miratuar vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, i ndryshuar, qëllimi i se cilës është të përcaktojë rregullat për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KZAZ-së, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10019, datë 29.12.008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë së është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

2. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Qëllimi i këtij projektvendimi është përmirësimi dhe përditësimi i dispozitave të rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), duke përfshirë mekanizma më të qartë për proceset e depozitimit të dokumenteve, vetëdeklarimet e kandidatëve, dhe procedurat për dorëzimin e detyrave, si dhe për të adresuar problematikat e hasura në zgjedhjet pararendëse.

Përgjatë procesit të rekrutimit të anëtarëve të KZAZ-ve në zgjedhjet e datës 14 maj 2023, u konstatuan këto problematika:

- Propozimi i kandidaturave nga ana e subjekteve pa pëlqimin e kandidatit;
- Propozimi i disa anëtarëve të KZAZ-ve në listat shumemërore të subjekteve zgjedhore për kandidatë të këshillave apo në marrëdhënie pune me kandidatët (kryesisht punonjës të administratës së organeve të vetëqeverisjes vendore.
- Rezultoi se 40% e administratës zgjedhore e nivelit të dytë, KZAZ, ka pësuar ndryshime përgjatë gjithë periudhës së funksionimit të tyre.
- 96% e KZAZ-ve (88 nga 92) u prekën nga ndryshimet e partive politike duke dëmtuar stabilitetin, performancën e tyre dhe mungesën e miradministrimit të dokumentacionit të punës nga kjo trupe.
- Në 4 raste Komisioneri mori vendim shkarkimi për katër anëtarë të KZAZ-ve të cilët nuk u paraqitën në detyrë (3 anëtarë të propozuar nga PD dhe 1 nga PL).

Propozimet e paraqitura për miratim në këtë projekt vendim synojnë të adresojnë këto problematika si dhe lehtësimin e mënyrës së komunikimit ndërmjet partive politike me KQZ-ne, duke propozuar këto shtesa dhe ndryshime;

1. Në nenin 6, pika 2, është propozuar qartësimi i formatit të dorëzimit të listave, duke përfshirë përveç mënyrës manuale dorëzimin e listave të kandidatëve për anëtar/ sekretar KZAZ-je edhe platformat elektronike. Kjo qasje modernizon procesin dhe redukton mundësinë e gabimeve apo vonesave, duke garantuar përshtatshmëri me teknologjitë bashkëkohore.
2. Në nenin 6, pika 5, janë shtuar paragrafët c) dhe d). Respektivisht në paragrafin c) propozohet që të depozitohet vetëdeklarimi i kandidatëve mbi përmbushjen e kushteve dhe shmangien e papajtueshmërisë, me qëllim forcimin e integritetit të procesit dhe dekurajimin e propozimeve të papërshtatshme nga subjektet. Në paragrafin d) është propozuar që nga kandidatët për anëtar/sekretar KZAZ-je që janë nëpunës të administratës publike të dorëzohet kërkesa ose leja apo dokument i njëvlershëm nga punëdhënësi, duke siguruar përputhshmëri me legjislacionin për etikën e nëpunësit të administratës publike dhe nëpunësin civil si dhe me vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.
3. Në nenin 11, germa “ë”, propozohet qartësimi i procedurës që anëtarët e KZAZ-ve duhet të ndjekin në rast konflikti interesi me kandidatët, duke përfshirë detyrimin për njoftim të menjëhershëm të Komisionerit së bashku me dokumentacionin e provuar.
4. Në nenin 11, pika 2, propozohet vendosja e një procedure administrative për hetimin e pretendimeve dhe shqyrtimin e dokumentacionit nga administrata e KQZ-së, duke përmirësuar transparencën dhe eficiencën në trajtimin e ankesave.
5. Në nenin 12, pika 5, propozohet që dokumentimi i procesit të dorëzimit të detyrës të evidentohet në Librin e Protokollit të KZAZ-së dhe në një procesverbal të detajuar, për të shmangur paqartësitë dhe për të siguruar një tranzicion të rregullt të përgjegjësive dhe materialeve.
6. Në nenin 16, pika 3, është propozuar heqja e referencave për rrjetin telefonik fiks për të reflektuar realitetin teknologjik aktual, duke lehtësuar komunikimin dhe kostot për palët.

7. Në nenin 36, pikat 3 dhe 4 propozohen ndryshime që përfshijnë detyrimin për vetëdeklarim të anëtarëve lidhur me kushtet e konfliktit të interesit me kandidatët. Ky proces synon të rrisë transparencën dhe të garantojë paanësinë e administratës zgjedhore.

Këto ndërhyrje synojnë të sjellin përmirësimin e qartësisë dhe uniformitetit në procedurat e ndjekura nga KZAZ-të. Gjithashtu synohet rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë së kandidatëve dhe anëtarëve të KZAZ-së, duke shmangur konfliktet e interesit dhe duke garantuar përputhshmëri me kërkesat e Kodit Zgjedhor.

- a) **Forcimi i integritetit institucional**, duke dokumentuar qartë proceset e dorëzimit të detyrave dhe duke përfshirë të gjitha palët në mënyrë të barabartë dhe transparente.
- b) **Përmirësimi i administrimit të pretendimeve dhe ankesave**, përmes një qasjeje të standardizuar dhe të dokumentuar.

Projektvendimi ju është dërguar subjekteve të partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile për mendim. Organizata KRIIK ka kërkuar që në projektvendim që kandidatët të cilët janë nëpunës të administratës publike të dorëzohet kërkesa dhe leja apo dokument i njëvlershëm nga punëdhënësi për të dëshmuar në këtë mënyrë edhe ligjshmërinë e procedurave të ndjekura nga nëpunësi dhe administrata publike. Ky rekomandim u mor ne konsiderate nga administrata e KQZ-se dhe u reflektua edhe ne projektvendimin e paraqitur për miratim.

Ky propozim nga administrata e KQZ-së nuk gjen bazë ligjore për sa kohë ligji aktual nuk përmban ndonjë dispozitë që kërkon që kërkesat e kandidatëve për anëtar/sekretar të KZAZ-së dhe lejet e dhëna nga organet publike të jenë të formateve të miratuara nga KQZ, persa kohë marrëdhëniet ndërmjet kandidatëve të administratës zgjedhore dhe punëdhënësve janë marrëdhënie juridike që nuk mund të rregullohen nga legjislacioni zgjedhor.

Ndryshimet dhe shtesat e propozuara synon të adresojë sfidat aktuale në zbatimin e rregullores në fuqi, të forcojë qartësinë dhe transparencën e procedurave dhe të garantojë një administrim zgjedhor më efikas dhe të besueshëm.

Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim, projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 05, datë 20.11.2020, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të zonës së administrimit zgjedhor”, i ndryshuar.

Erion META – Drejtor Drejtorja e Administratës Zgjedhore

Pavlina DOCAJ – Drejtor Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda CELMETA – Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKT VENDIM
PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIM NR. 05, DATË 20.11.2020, "PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 20, paragrafi 1, shkronja "a", paragrafi 3, nenin 46, paragrafët 1 dhe 2, nenit 50, paragrafi 3, neneve 52, 62, 93, 108, paragrafi 7 dhe nenin 109, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

- I. Në tekstin e Vendimit nr. 05, datë 20.11.2020, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-se", i ndryshuar, të Komisionit Rregullator, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:
 1. Në nenin 6, në fund të pikës 2, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
 - a. "Në çdo rast lista paraqitet dhe/ ose në platformën elektronike të dedikuar nga personi përgjegjës i autorizuar nga KQZ me kredencialet përkatëse në këtë sistem."
 2. Në nenin 6, pika 5, pas germës b), shtohen germa c) dhe ç), me këtë përmbajtje:
 - a. c) Vetëdeklarimin e kandidatit se plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 31 të Kodit zgjedhor dhe se nuk është në kushtet e papajtueshmërisë sipas përcaktimeve të nenit 30 të Kodit Zgjedhor,
 - b. ç) për kandidatet që janë nëpunës të administratës publike dorëzohet kërkesa dhe leja e dhënë nga punëdhënësi për t'u angazhuar si anëtar i administratës zgjedhore apo një dokument i njëvlershëm;
 3. Në nenin 11 germa "ë" ndryshohet si më poshtë vijon:

"ë) Në rast se anëtari/ sekretari i KZAZ-së ose subjektet zgjedhore evidentojnë ose dyshojnë se një anëtar ose sekretar i KZAZ-së është në një nga kushtet e papajtueshmërisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni duhet të informojë menjëherë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve me një raport të argumentuar, të shoqëruar me faktet dhe dokumentacionin që provon ekzistencën e kushteve të parashikuara në këtë paragraf."
 4. Në nenin 11, shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

Data: xx.xx.2025 Nr:
Ora: xx:xx



Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin 05, datë 20.11.2020,
"Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e
komisionit të zonës së administrimit zgjedhor", i ndryshuar

2. "Administrata e KQZ heton administrativisht pretendimet e palëve dhe shqyrton dokumentacionin e paraqitur duke përfshirë konsultimin apo komunikimet në rrugë elektronike me palët dhe përgatit një raport të detajuar me gjetjet dhe rekomandimet e tij."
5. Në nenin 12, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:
- a. "Anëtari/ sekretari merr në dorëzim detyrën duke plotësuar një procesverbal në të cilin përmbledhen dokumentet e administruara, plotësuara dhe të gjitha materialet e dorëzuara me anëtarin/ sekretarin që largohet. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet menjëherë KQZ-se dhe një kopje administrohet nga Sekretari i KZAZ-se."
6. Në nenin 16 pika 3, pas togfjalëshit fjalës telefonike, hiqet togfjalëshi "të rjetit fiks".
7. Në nenin 26, pika 3 dhe 4 ndryshon si më poshtë vijon:
- "3. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së, brenda 5 ditëve pas publikimit të listës së kandidatëve për deputet / organeve drejtuese të njësisive të vetëqeverisjes vendore, duhet të vetëdeklarojë nëse është ose jo në marrëdhënie krushqie, gjinie apo marrëdhënie pune me ndonjë prej kandidatëve sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 2 e Kodit Zgjedhor. Në çdo rast nëse anëtari i KZAZ-së emërohet pas kësaj periudhe duhet të dorëzojë në KQZ edhe formularin e vetëdeklarimit të konfliktit të interesit sipas modelit të miratuar nga Komisioneri.
4. Sekretari i KZAZ-së dërgon në KQZ jo më vonë se 2 ditë pas afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, vetëdeklarimet e anëtarëve/ sekretarit të KZAZ-së. Në rastet kur anëtari ka deklaruar se është në kushtet e konfliktit të interesit, KQZ-ja i kërkon subjektit politik propozues të sjellë një propozim tjetër për zëvendësimin e anëtarit në fjalë brenda 3 ditëve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- III. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar

Data: xx.xx.2025 Nr:
Ora: xx:xx



Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin 05, datë 20.11.2020, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të zonës së administrimit zgjedhor", i ndryshuar